

RAPORTI PERFUNDIMTAR
I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
PËR
VLERËSIMIN E JASHTËM TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

*Master Profesional (MP) në
Menaxhim Biznesi
me profil: Menaxhim Arsimi*

NË INSTITUCIONIN E ARSIMIT TË LARTË PRIVAT
“SHKOLLA E LARTË PRIVATE MESDHETARE E SHQIPËRISË”

Grupi i vlerësimit të jashtëm

Prof. Dr. Nikoleta Mita (Kryetare)

Prof. Dr. Raimonda Duka (antare)

Tiranë, Maj 2012

Përmbajtja e raportit

1. Hyrje
2. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
3. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT
BËHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
4. PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA
PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR
DHE PERSONELI ADMINISTRATIV
5. INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE
6. INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE
BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI
7. INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME
DHE TË JASHTME
8. INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË
9. Analiza SWOT
10. REKOMANDIME

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Hyrje

Ky raport përmban gjetjet e vlerësimit të jashtëm të kryer në kuadrin e kërkesës së IAL-së për programin e studimeve "Master Profesional" në "Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi".

"Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë" është një institucion i arsimit të lartë privat i krijuar në bazë të ligjit nr.9741, dt 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.156, datë 22.03.2001, "Për shkollat jo-publike në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.177, datë 19.02.2009 "Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë". SHLPMSH e ka filluar aktivitetin mësimor gjatë vitit akademik 2009-2010 dhe ofron programe studimi të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe të ciklit të dytë të studimeve (Master i Shkencave dhe Master Profesional). Programet e ciklit të dytë të studimeve janë hapur në vitin akademik 2011-2012.

Grupi i vlerësimit të Jashtëm e ka zhvilluar veprimtarinë vlerësuese bazuar në dokumentete ligjore të mëposhtme:

1. Ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me ligjet Nr. 9832, datë 12.11.2007, Nr. 10 307, datë 22.7.2010, Nr. 1 0 493, datë 15.12.2011 dhe aktet nënligjore të dalta në bazë të tij.
2. Vendimet e Këshillit të Ministrave për hapjen e programeve të studimit pranë "Shkollës së lartë private Mesdhetare të Shqipërisë".
3. Udhëzimet e MASH-it për projektimin e programeve të studimit, për hapjen dhe funksionimin e institucioneve private të arsimit të lartë, për transferimin dhe njohjen e krediteve, për administrimin e dokumentacionit, etj.
4. Urdhëri nr.134 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, datë 21.03.2011 "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë të institucioneve të arsimit të lartë".
5. Udhëzuesi APAAL mbi vlerësimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë.
6. Aspektet dhe treguesit e vlerësimit të cilësisë në Arsimin e Lartë (APAAL).

Përbërja e GVJ

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm për programin Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi përbëhet nga :

Nikoleta Mita (kryetare)
Raimonda Duka (anëtare)

Veprimtaria e GVJ u asistua nga punonjës të Agjencisë Publike së Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL).

Parimet e Punës së GVJ

Për realizimin e vlerësimit dhe hartimin e këtij raporti, GVJ u mbështet në parimet e mëposhtme:

- **Besueshmëria**

Gjetjet janë të besueshme, pasi ato janë bazuar në prova të besueshme.

- **Kompetenca**

Anëtarët e GVJ zotërojnë ekspertizën dhe kompetencat që e garantojnë cilësinë e procesit të vlerësimit.

- **Integriteti/Ndershmëria**

Vlerësuesit garantojnë ndershmërinë dhe integritetin e procesit të vlerësimit në tërësi, konsistencën e veprimeve, vlerave, metodave.

- **Pavarësia**

Parimi i pavarësisë ka dy dimensione: a) shmangja e konfliktit të interesit dhe b) sigurimi i pavarësisë së gjykimit që do të thotë se përfundimet e vlerësimit nuk janë të ndikuara ose të marra nën presion nga një palë tjetër.

- **Paanësia**

Vlerësimi paraqet një tablo të balancuar të anëve të forta dhe të dobta të aspekteve të vlerësuara. Procesi i vlerësimit demonstroi paanësi në të gjitha etapat e tij: Në vizitën në institucion, në takim me pedagogët, studentët, administratën, të interesuarit, në analizën dhe prezantimin e gjetjeve.

- **Transparenca**

Ky parim kërkon që palët në vlerësim të jenë të vetëdijshme për arsyen e vlerësimit, kriteret me të cilat vlerësimi kryhet, qëllimet dhe procedurat. Sipas këtij parimi dokumentet e IAL dhe raporti i vlerësimit të jashtëm janë lehtësisht të lexueshëm dhe të disponueshëm për të gjitha palët e interesuara.

- **Mbështetja në një shumëllojshmëri burimesh**

Vlerësimi u bazua në të dhënat e mbledhura nëpërmjet: Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të “Shkollës së lartë private Mesdhetare të Shqipërisë”; të dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet e gjithë veprimtaria e zhvillimit të programeve mesimore, të tilla si: Statuti i IAL-së, Rregullore e IAL-së, Rregullore e Studimeve për programin që vlerësohet, dosjen e programit të studimit, regjistrat e të dhënave për studentët, dokumentacioni i sekretarisë mesimore, dokumentacioni i personelit; vizitës në institucion, intervistave me drejtues të IAL-së, me pedagogë, studentë dhe punonjës të administratës së IASL-së.

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi

Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” është miratuar të hapet me Vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 256 datë 16.09.2011 dhe është hapur me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.482, datë 03.10.2011.

Procesi mësimor ka filluar në nëntor 2011. Këtë program studimi e ndjekin tre studentë.

Tabela format për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit “ Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi ” mbështetur në Standardet Shtetërorë të Cilësisë për Programet e Studimit të Ciklit të Dytë	
Standardet/kriteret	Mendimi i GVJ për përmbushjen e standardit/kriterit ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Programi që ofron institucioni është miratuar nga Këshilli i Akreditimit më 16.09.2011 dhe ofrohet në bazë të lejës së dhënë nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës me Urdhërin Nr.482, datë 03.10.2011. Programi është i organizuar në module, të cilat janë të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Plani mësimor i këtij programi parashikon ngarkesën me 60 kredite të shpërndara në dy semestra.
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Misioni i programit të studimit përputhet me qëllimet dhe misionin e institucionit.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Programi i përgjigjet kërkesës për menaxherë të arsimit, një specializim i munguar.
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Programi mban parasysh zhvillimin ekonomik të vendit, e theksuar kjo edhe për arsyen se ky iAL ka në fokus programet e fushës së ekonomisë.
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Programi i studimit pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Në programin që vlerësohet kjo realizohet përmes përfshirjes në programin e lëndëve të temave që trajtojnë vlera të arsimit shqiptar dhe ndikimin e tyre në kontekstin e zhvillimeve globale.
Konkluzione: Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” përputhet me misionin dhe qëllimin e Institucionit. <u>Ky standard përmbushet plotësisht.</u>	
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit	Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” është përshtatur me strategjinë për zhvillimin e institucionit.
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;	Programi “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” i pajis studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike.
Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;	Programi “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” mban parasysh programin Bachelor në Menaxhim, por synon një specializim të thelluar në menaxhim arsimit.

<p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p>	<p>Ky kriteri nuk aplikohet për këtë program</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p>Ky kriteri nuk aplikohet për këtë program</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	<p>Ky kriteri nuk aplikohet për këtë program</p>
<p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi synon formimin e specialistëve të menaxhimit të arsimit. Objektivat e programit janë të arritshme, plotësimi i tyre ndihmon në përgatitjen e menaxherëve të arsimit kryesisht në nivelin e sistemit dhe përputhet me nevojat e tregut të punës.</p>
<p>Konkluzione: Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” përputhet me strategjinë për zhvillim të institucionit; bazohet në studimet bachelor në fushën e menaxhimit të biznesit, krijon mundësi për thellimin e njohurive teorike dhe praktike dhe ndihmon në përgatitjen e specialistëve në përputhje me nevojat e tregut të punës vendas. <u>Ky standard përmbushet plotësisht.</u></p>	
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p>	<p>GVJ konstatoi që përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Ky kriter është mbajtur parasysh që në momentin e hartimit të programit të studimit.</p>
<p>Konkluzione: Në hartimin dhe zbatimin e këtij programi, është mbajtur parasysh plotësimi i kushteve dhe parakushteve të rrjedhura nga Ligji i Arsimit të Lartë dhe Udhëzimet përkatëse të MASH. Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimet përkatëse të MASH. <u>Ky standard përmbushet plotësisht.</u></p>	
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p>	<p>Objektivat e këtij programi përputhen me nivelin e studimeve të ciklit të dytë në të cilin ofrohen.</p>

<p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Vlerësimi i studentëve realizohet përmes dy formave kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kontrolli i dijes në provimin përfundimtar që përmban pyetje të hartuara për të matur rezultatet e nxënies në modulin përkatës dhe përbën 60% të vlerësimit përfundimtar. 2. Detyrave (tema, detyra kursi, prezantime) që lidhen me aplikime praktike të modulit dhe që përbën 40% të vlerësimit përfundimtar.
<p>Konkluzione: Programi i studimeve ofrohet në përshtatje me objektivat e ciklit të dytë të studimeve. Vlerësimi i studentëve bëhet duke kombinuar vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin përmbledhës. Forma e vlerësimit është e njëjtë për të gjitha modulet e programit dhe nuk parashikon forma specifike vlerësimi sipas mundësive që ofron moduli. <u>Ky standard përmbushet.</u></p>	
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disave vende dhe praktikatat e mira të vendeve europiane</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit” është hartuar duke mbajtur parasysh përvojën e disa universiteteve me të cilat “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” bashkëpunon.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p>	<p>Programi i ofruar përmban elemente që respektojnë standardet më të mira ndërkombëtare të kurrikulës universitare, të përcaktimit të krediteve, të kriterëve të pranimit dhe përpqet t'i integrojë me vlerat më të mira të arsimit universitar në Shqipëri. Megjithatë për ta bërë plotësisht të konkurrueshëm më tepër kujdes duhet kushtuar për përcaktimin e rezultateve të të nxënies bazuar në përkrahjet e Dublinit, në të nxëniet e bazuar në kërkim, në pasqyrimin e dimensionit evropian dhe në përdorimin e një sistemi vlerësimi më të shumëllojshëm.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjisllacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i ofruar është ndërtuar në frymën e përgjithshme të legjisllacionit dhe direktivave të BE për arsimin e lartë.</p>
<p>Konkluzione: Programi i studimit është ideuar dhe realizohet mbi bazën e përvojës dhe modele të disa universiteteve të huaja me të cilat “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” bashkëpunon. Programi pritet për të arritur dimensionin ndërkombëtar dhe për ta integruar atë me vlerat më të mira të arsimit të lartë shqiptar. <u>Ky standard përmbushet.</u></p>	
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit” synon pajisjen e studentëve me aftësi profesionale dhe të kërkimit në fushën e menaxhimit të arsimit. Komponenti i praktikës me 6 kredite dhe ai mikrotezës me 8 kredite pritet të realizojnë këtë kriter.</p>

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” Përputhet me profilin e “Shkollës së lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” dhe me strategjinë e zhvillimit të këtij institucioni.</p>
<p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Dokumentacioni i Programit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” dëshmon se dy pedagogët me kohë të plotë të janë të angazhuar në veprimtarinë kërkimore shkencore dhe veprimtaria e tyre e spikatur në fushën e kërkimit integrohet me mësimdhënien dhe ndihmon në realizimin e synimeve të programit të studimeve. Por nga ana tjetër nuk evidentohet veprimtaria shkencore e personelit akademik me kohë të pjesshme, i doli përbën shumicën e personelit të angazhuar për të realizuar këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Veprimtaria e personelit akademik me kohë të plotë përputhet me synimet që ka përcaktuar programi.</p>
<p>Konkluzione: Programi është një kontribut i “Shkollës së lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” për përgatitjen e specialistëve të menaxhimit të arsimit në nivelin e sistemit dhe synon aftësim praktik dhe në kërkim. Programi përputhet me profilin e këtij IAL-je, me strategjinë e zhvillimit të saj. Dëshmohet se personeli i brendshëm integron veprimtarinë mësimore me atë kërkimore, por kjo nuk dëshmohet për personelin e jashtëm. <u>Ky standard nuk përmbushet plotësisht.</u></p>	
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p>	<p>Tregu i punës ka nevojë për specialistë në fushën e menaxhimit të arsimit dhe ky program i përgjigjet kësaj nevoje.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi synon të plotësojnë nevojat për specialistë në menaxhimin e arsimit.</p>
<p>Konkluzione: “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” ofrohet në përputhje me nevojat e tregut vendas të punës. <u>Ky standard plotësohet.</u></p>	
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p>	<p>Programi i studimit përputhet me synimin e strategjisë kombëtare për reformimin e menaxhimit të arsimit.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e 	<p>“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” nuk dëshmon të ketë bërë një studim tregu për mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar, kërkesat e punëdhënësve. Numri i pritshëm i studentëve që mund të regjistrohen në këtë program mbështetet më tepër në rastësinë sesa mbi një studim paraprak.</p>

<p>prishëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	
<p>Konkluzione: Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” synon të plotësojnë nevojat e tregut të punës në fushën e menaxhimit të arsimit, por synimi nuk mbështet në një evidencë të vlerësimit të nevojave të tregut të punës. <u>Ky standart nuk përmbushet.</u></p>	
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p>	<p>Programi i studimeve “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ai synon të përgatisë specialistë që do të punojnë për zhvillimin e sektorit të arsimit.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimeve synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p>Konkluzione: Programi i studimeve në “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” synon ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe të interesave kombëtare. <u>Ky standart përmbushet plotësisht.</u></p>	
<p>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p>	<p>Raporti i vlerësimit të brendshëm dhe intervistat me drejtues të IAL-së dëshmojnë se “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ka përcaktuar një metodologji për të vlerësuar programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p>	<p>Institucioni nuk e ka përfshirë këtë informacion në raportin e vlerësimit të brendshëm.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p>	<p>Ky është vlerësimi i parë i për programin dhe është në proces, kështu që nuk është pasqyruar ende në faqen e internetit të IAL-së.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: <u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në 	<p>Nga raporti i vlerësimit të brendshëm dhe intervistat me pedagogë dhe studentë konstatohet se IAL ka përcaktuar metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për kryerjen e vlerësimit, por IAL nuk na ofroi ndonjë formular tip ose evidencë të rezultateve të vlerësimit të lëndëve të kryera deri në momentin e vlerësimit.</p>

<p>provimet e vlerësuar me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
<p>Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ka përcaktuar instrumente të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e programit, por përdorimi i këtyre instrumenteve nuk dëshmohet. <u>Ky standart përmbushet pjesërisht.</u></p>	
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p>	<p>“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” parashikon të hartojë një plan strategjik në përfundim të vitit akademik 2011-2012.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” do të hartojë një plan strategjik për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit pas mbylljes së vitit akademik 2011-2012.</p>
<p>Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” parashikon të hartojë një plan strategjik për zhvillimin e programeve të studimit, për përmirësimin e mësimdhënies dhe të të nxënit në fund të vitit akademik 2011-2012 i cili është viti i parë i ofrimit të këtij programi studimi. Periudha e shkurtër e zbatimit të këtij programi prej 6 muajsh nuk mundëson përmbushjen e plotë të këtij kriteri. <u>Ky standard përmbushet pjesërisht.</u></p>	
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Ky kriteri nuk aplikohet për këtë program.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit realizohet me 60 kredite, dhe kohëzgjatja është 1 vit akademik me kohë të plotë. Ka një mospërputhje me Urdhërin e Ministrit të Arsimit nr. 482, datë 03.10.2011 në të cilin jepet leja për programe master profesional me 90 kredite dhe kohëzgjatje</p>

	normale 1.5 vjet).
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program.
Konkluzione: Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” realizohet me 60 kredite. Ka një kohëzgjatje 1 vit akademik në sistemin me kohë të plotë. Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Ligji i Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por nuk përputhen me Urdhërin e Ministrisë të Arsimit nr. 482, datë 03.10.2011.	
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	
Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” nuk ka bërë publikime të tilla, por ka planifikuar botimin e materialeve informuese në lidhje me vlerësimin e brendshëm.
Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.	“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” nuk ka të publikuara në faqen e internetit publikime që lidhen me vlerësimin e brendshëm.
Konkluzione: Programi “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” ka filluar veprimtarinë në vitin 2011 dhe IAL-ja nuk ka botuar ende informacione që lidhen me vlerësimin e brendshëm për këtë program. IAL ka planifikuar të publikojë materiale të tilla. <u>Për plotësimin e këtij standardi nuk mund të shprehemi.</u>	
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.	
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ka kriteret për pajtimin në punë të personelit të brendshëm dhe të jashtëm dhe përzgjedhja e tij është bërë në përputhje me këto kriteret.
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ i IAL-së ishte angazhuar në zbatimin e detyrave mbështetur në kontratën e punës.

Konkluzione: Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve. Në kontratat e punës dhe të shërbimit janë specifikuar përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të ofruara. <u>Ky standard përmbushet.</u>	
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Struktura organizative e “Shkollës së lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” i shërben përmbushjes së misionit të saj.
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ka tre fakultete.
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	Fakulteti i Shkencave Ekonomike ka dy njësi bazë: Departamentin Financë Bankë dhe Kontabilitet dhe Departamentin e Menaxhimit. IAL-ja ka një qendër e cila është e përbashkët në këtë stad të zhvillimit të institucionit.
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	Objektivat e njësive bazë janë të përcaktuara në statutin dhe rregulloren e IAL-së Ato janë të publikuara dhe në faqen zyrtare të UMSH.
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.	Fakulteti i Shkencave Ekonomike ka dy persona të punësuar me kohë të plotë nga të cilët njëri është me titull profesor.
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ishte organizuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të saj. “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ka tre Fakultete. Secili fakultet ka dy departamente dhe një qendër që ishte e përbashkët. IAL-ja nuk plotëson kriterin 5. <u>Ky standard përmbushet pjesërisht.</u>	
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;	Njësia bazë që mbulon programin që vlerësohet ishte e ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kishte për realizimin e programit të studimit.
Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.	Dekani dhe stafi I BNJ përfshiheshin në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.
Konkluzione: Njësitë bazë dhe kryesore të “Shkollës së lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” angazhoheshin drejtpërsëdrejti për realizimin e programeve të studimeve dhe i njihnin përgjegjësitë e tyre në lidhje me rekrutimin e personelit akademik për realizimin e programeve. Bazuar në rregullat e brendshme të IAL-së këto njësi bënë dhe vlerësimin e personelit akademik. <u>Ky standard përmbushet.</u>	
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Të gjitha kurrikulat e “Shkollës së lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ishin hartuar nga stafi akademik i këtij institucioni.
Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe rregullat e brendshme të IAL-së.

Konkluzione: Personeli akademik ishte angazhuar në hartimin e kurrikulës dhe vendimet në lidhje me organizimin e programeve të studimit. Rekrutimi dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe rregullat e brendshme të IAL-së. <u>Ky standard përmbushet.</u>	
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” e zhvillon veprimtarinë e saj në një godinë të marrë me qera e cila kishte të gjitha mjediset e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe administrative.
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Mjediset janë marrë me qera për një periudhë 10 vjeçare.
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Mësimdhënia dhe aktivitetet e tjera zhvilloheshin në të njëjtën godinë duke mundësuar një menaxhim të efektshëm dhe kontroll të vazhdueshëm.
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ka infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë. Mjediset dhe pajisjet janë të standardeve bashkëkohore, dhe ofrojnë një shërbim cilësor. Godina është funksionale dhe ka kapacitetet e kërkuara. Ajo është marrë me qera për një periudhë 10 vjeçare. <u>Ky standard përmbushet plotësisht.</u>	
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve .	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Studentëve iu ofrohej informacion në lidhje me programin e studimit që në fillim të procesit mësimor. Studentëve i viheshin në dispozicion plani mësimor dhe programet lëndore, si dhe fletëpalosje informative.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Informacioni për programet e studimit i ofrohej studentëve në formë të shkruar dhe elektronike, por ai nuk është i publikuar në faqen zyrtare të internetit.
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” i siguron studentëve informacion të mjaftueshëm për programin e studimit si në formë të shkruar dhe elektronike, por në faqen zyrtare të IAL-së ky informacion nuk pasqyrohet. <u>Ky standard përmbushet.</u>	
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Analiza vjetore për programin që vlerësohet parashikohet në përfundim të tij.
Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të	“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” nuk ka hartuar ende politika për përmirësim pasi

dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	programi është në proces. Korniza rregullatore e institucionit parashikon hartimin e politikave të tilla.
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” parashikon nëpërmjet rregullave të saj të brendshme kryerjen e analizës vjetore për vlerësimin dhe ecurinë e programeve të studimit dhe për përmirësimin, por GVJ nuk pati mundësi të jepte një gjykim rreth tyre pasi programi kishte vetëm 6 muaj që vepronte. <u>Ky standard përmbushet pjesërisht.</u>	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Rregullorja e IAL-së ka disa rregulla për diplomimin, ndërsa Rregullorja e Programit të Studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit” nuk parashikon procedurën e diplomimit. Nga intervista me koordinatorin e programeve master mësohet se IAL-ja ka një ide sesi do ta zhvillojë planin e diplomimit, por nuk ka nje dokument të veçantë për të.
Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Konkluzione: IAL-ja ka disa rregulla të përgjithshme, por nuk ka një dokument të posaçëm për planifikimin e diplomimit dhe kërkesat për provën finale. <u>Ky standard përmbushet pjesërisht</u>	
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion, në momentin e vlerësimit, rezulton se institucioni ishte në mes të një procesi auditimi të pasqyrave financiare. Audituesi i jashtëm është shoqëria AIEL Auditors.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Për sa kohë që institucioni kryen auditim ligjor të pasqyrave financiare mund të dalim në përfundimin që raporti duhet të përmbajë grantet e përfituara apo kontratat e shërbimit për realizimin e programeve.
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Përsëri mund të besojme që ky informacion do të jetë pjesë e Raportit të Auditimit
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” i nënshtrohet procesit të auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare çdo vit. Ky proces auditimi nënkupton plotësimin e kritereve të këtij standardi, por që nuk është i konfirmuar nga GVJ.	
III - PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV.	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit. Këto rregulla përmbahen në mënyrë të detajuar në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe u verifikuan gjatë takimit në zyrën

	e burimeve njerëzore.
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;	Nga 7 pedagogë të parashikuar për zhvillimin e 7 lëndëve mësimore të programit vetëm dy janë të brendshëm. Ky kriter realizohet në masën 28%.
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Kuadri rregullativ i IAL-së përmban procedura transparente të vlerësimit të personelit.
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	Zyra e burimeve njerëzore ka një bazë të dhënash (dosje personale aplikimi dhe punësimi) për të gjithë personelin.
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ka përcaktuar politikën e rekrutimit, të përzgjedhjes dhe të vlerësimit të personeli dhe procedurat janë transparente. Ekzistojnë dosjet personale të personelit të punësuar në IAL. <u>Ky standard përmbushet pjesërisht.</u>	
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	Përgjegjësi i programeve master ka gradën doktor të fituar në një universitet përëndimor.
Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	Titullari dhe pedagogët e lëndëve/moduleve në programin e studimit kanë gradën shkencore “Doktor”. Dy kanë titullin akademik Profesor, ndërsa dhe dy mbajnë titullin Profesor i Asociuar.
Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;	Ky kriter plotësohet.
Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ka stafin e nevojshëm për të udhëhequr dhe mbikëqyrur praktikat profesionale në këtë program studimi.
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” i <u>plotëson kriteret e këtij standardi</u> . Numri i kufizuar i studentëve, i mundëson IAL-së të realizojë mbikëqyrjen e praktikës.	
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Personeli akademik me kohë të plotë dhe një pjesë e atij me kohë të pjeshme publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën

	përkatëse.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Ky personel jep jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës.
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ka angazhim të personelit akademik me kohë të plotë në veprimtari shkencore. <u>Ky kriter plotësohet.</u>	
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” <u>nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj.</u>	
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Konkluzione: Ky standard nuk aplikohet për këtë programet e studimit Master profesional .	
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Konkluzione: Ky standard nuk aplikohet për këtë programet e studimit Master profesional .	

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	Programi i studimeve “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” nuk kërkon përdorimin të laboratorëve.
Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Numri i studentëve është shumë i vogël dhe për këtë program pjesa më e madhe e burimeve njerëzore janë staf akademik i jashtëm. Personeli ndihmës i përgjigjet numrit të studentëve.
Konkluzione: Personeli i “Shkollës së lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” shfaq një angazhim optimal për përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. <u>Ky standard përmbushet.</u>	
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;	Ky kriter përmbushet. Ngarkesa mësimore e një pedagogu të brendshëm është 120 orë sipas Rregullores së IAL-së.
Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	Kriteri përmbushet.
Konkluzione: Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në Rregulloren e IAL-së. Kjo ngarkesë është 120 orë mësimore. <u>Ky standard përmbushet.</u>	
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” Ka të dhëna për personelin të sistemuara në dosjen personale të secilit pedagog.
Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” disponon listën e plotë të personelit akademik që ishte përfshirë në programin e studimit që vlerësohet.
Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.	Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit ishin të përcaktuara dhe publikoheshin nga IAL.
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ka një zyrë të burimeve njerëzore e cila merret me politikën e rekrutimit dhe të vlerësimit të personelit dhe ruan të gjitha të dhënat për personelin. <u>Ky standard përmbushet.</u>	
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” nuk kishte programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik.
Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” përpiqet ta përmbushë këtë kriter duke i përfshirë pedagogët në zbatimin e projekteve kërkimore të

	financuara nga IAL-ja dhe burime të tjera, duke mbështetur pjesëmarrjen në konferenca dhe botime. Kjo lloj mbështetje nuk u dokumentua për GBJ.
Konkluzione Informacioni që pati në dispozicion GVJ nuk i mundëson shprehjen në lidhje me përmbyshtjen e këtij standardi.	
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore -shkencore të personelit akademik të tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Nuk ka të dhëna të sistemuara. Këto të dhëna janë në CV-të e personelit akademik.
Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ka një bibliotekë, për të cilën disponon një bazë të dhënash. Në këtë bibliotekë gjendet edhe botime të personelit akademik të IAL-se.
Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	Nuk ka të dhëna për këtë kriter.
Konkluzione: Të dhënat e personelit për veprimtarinë kërkimore dhe botuese ndodhen në CV-të e tyre . IAL nuk ka të dhëna të sistemuara për veprimtarinë kërkimore dhe botuese të personelit akademik. Lidhja e veprimtarisë kërkimore dhe botuese të personelit ka pikëtakime me fushën e programit të studimit. <u>Ky kriter plotësohet pjesërisht.</u>	
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ka përcaktuar procedurat dhe kriteret e pranimit në programin Master profesional. Studentët që të pranohen në programin e studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” duhet të zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe të kenë grumbulluar 180 kredite ECTS.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Kriteri nuk aplikohet për këtë program
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Nga verifikimi i dokumentave të regjistrimit në sekretarinë mësimore u konstatua që studentët e regjistruar plotësonin të gjitha kriteret e pranimit të vendosura nga institucioni.
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master	Ky kriter nuk mund të verifikohet pasi viti akademik ishte në vazhdim. Studentët ishin të informuar se deri në fund të këtij programi studimi duhet të jepnin gjuhën angleze të nivelit B2.

Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;	
Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.	Historiku i shkurtër i programit, nuk na dha mundësinë të gjykojmë në lidhje me këtë kriter.
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ka përcaktuar kriteret e pranimit për programin MP sipas rregullave në fuqi. Institucioni plotëson kriteret e këtij standardi. <u>Ky standard përmbushet.</u>	
Standardi IV. 2 - Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” u jep studentëve informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të programit të studimit.
Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;	Studentëve u jepej informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion.
Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.	“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ofron shërbimin e këshillimit të karrierës.
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” i informonte studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. <u>Ky standard përmbushet plotësisht.</u>	
Standardi IV. 3 - Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;	Akreditimi i programit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit” kërkohet për herë të parë dhe periudha kohore nuk e mundëson plotësimin e këtij kriteri.
Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;	Akreditimi i programit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit” kërkohet për herë të parë dhe periudha kohore nuk e mundëson plotësimin e këtij kriteri.
Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	Akreditimi i programit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit” kërkohet për herë të parë dhe periudha kohore nuk e mundëson plotësimin e këtij kriteri.
Konkluzione: Akreditimi i programit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit” kërkohet për herë të parë dhe periudha kohore e shkurtër e zbatimit të këtij programi (6 muaj) nuk e mundëson plotësimin e këtij kriteri.	

Standardi IV. 4 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;	Institucioni ka statistika vjetore për numrin e studenteve në ciklin e dytë (MP), por ende nuk ka të diplomuar në këtë program studimi. Për këtë arsye ky kriter nuk mund të verifikohet.
Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	Aktualisht “Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” nuk ka programe, të cilat do t’i mundësonin studenteve regjistrimin në ciklet e tjera të studimit.
Konkluzione: Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë, por ende nuk ka studentë të diplomuar në këtë program studimi dhe për rrjedhojë nuk ka statistika të punësimit të studentëve pas diplomimit.	
Standardi IV. 5 - Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;	Sekretaria mësimore dhe personeli akademik informon në mënyrë të vazhdueshme studentët për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit.
Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë programit dhe do të informohen në përfundim të programit.
Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Pedagogët u japin vazhdimisht studentëve feedback për rezultatet akademike dhe u komunikojnë vlerësimet.
Konkluzione: Institucioni ndjek politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve dhe të detajuar jo vetëm për programet dhe afatet e përfundimit të moduleve, por dhe të vlerësimit të tyre gjatë dhe në përfundim të programit. <u>Ky standard përmbushet plotësisht.</u>	
Standardi IV. 6 - Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ka Zyrën e Këshillimit të Karrierës e cila këshillon studentët e programeve master për mundësitë e punësimit në sektorin publik dhe privat.
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Zyra e Këshillimit të Karrierës u jep ndihmë studentëve në përzgjedhjen e institucioneve apo kompanive për zhvillimin e praktikës profesionale. Studentët nuk kishin filluar praktikat profesionale dhe ishte e pamundur të verifikohet ky kriter.
Konkluzione: “Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” organizon praktikën profesionale dhe u asiston studentëve përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Kjo zyrë i ndihmon studentët në çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor, praktikat profesionale dhe i këshillon për praktikat profesionale. <u>Ky standard përmbushet plotësisht.</u>	
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1	

- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” kishte siguruar një pjesë të tekste mësimore dhe literaturës ndihmëse për programin që vlerësohet.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Literatura në bibliotekë për programin “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” ishte e kufizuar.
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” nuk ka bibliotekë elektornike, por librat tekstet dhe literaturat e printuar u vinin në ndihmë studentëve për plotësimin e objektivave të programit. Sipas studentëve nga 6 lëndë të zhvilluara për 2 prej tyre kishin tekste, ndërsa për 4 prej tyre punonin me leksione të përgatitura nga pedagogët.
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;	“Shkolla e lartë private Mesdhetare të Shqipërisë” ka një parashikim për shtimin e fondit të librave.
Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	Institucioni ka një planifikim të mirë të aktiviteteve mbështetëse në shërbim të procesit mësimor; oraret janë të shpallura në hyrje të bibliotekës dhe në hollin e katit të parë.
Konkluzione: Institucioni ka një bibliotekë e cila e vënë në shërbim të studentëve libra dhe revista, por fondi është i kufizuar për programin “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” <u>Ky standard përmbushet pjesërisht.</u>	
Standardi V. 2 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;	Institucioni, për realizimin e programit të studimeve, ka numër të mjaftueshëm klasash me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. IAL ka një laborator me PC për studentët si dhe pajisjet e nevojshme për stafin akademik dhe stafin ndihmës.
Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;	Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit.
Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;	Laboratori i informatikës ka aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimeve.
Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	Programi mësimor nuk parashikon praktika laboratorike, por IAL-ja ka një laborator informatike që mund të përdoret në funksion të programit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi”.

<p>Konkluzione: Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve mjedise të përshtatshme mësimore dhe laboratorin e informatikës. <u>Ky standard është plotësuar nga IAL.</u></p>	
<p>Standardi V. 3 - Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p>	<p>“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” nuk ka marrëveshje me institucione për realizimin e praktikave profesionale të programit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi”, por ajo sipas një dokumenti plotësues që ka dorëzuar shpjegon që praktikat do të kryehen në IAL.</p>
<p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet për këtë program</p>
<p>Konkluzione: IAL nuk ka marrëveshje me institucione për realizimin e praktikave profesionale, por praktikat do të kryehen në IAL. <u>Ky standard përmbushet.</u></p>	
<p>VI - INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE</p>	
<p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;</p>	<p>UMSH nuk ka dokumentuar në raportin e vlerësimit të brendshëm situatën financiare. Në raport thuhet se “Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” është audituar nga AIEI Auditors për periudhën 2009-2011.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Të dhënat mbi qëndrueshmërinë financiare nuk jepen në raport dhe për to nuk është marrë informacion as gjatë vizitës në institucion. Për plotësimin e këtij kriteri nuk mund të shprehemi.</p>
<p>Konkluzione: Institucioni ka një përdorim të kënaqshëm të informacionit për qëllime të vendimarrjes, por informacioni i kosto-drejtimit është vetëm për stafin drejtues dhe nuk u vu në dispozicion të GVJ. Ne nuk kishim aksesin e nevojshëm për vlerësim e situatës financiare. Ky proces auditimi nënkupton <u>plotësimin e kriterëve të këtij standardi, por që nuk është i konfirmuar nga GVJ.</u></p>	
<p>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</p>	
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p>	<p>“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ka nxitur bashkëpunimin të efektshëm ndërmjet personelit të saj. Gjatë vizitës u konstatua një klimë pozitive, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ndërmjet personelit të IAL-së.</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” Kka ndarje të qartë të detyra sipas vendeve të punës dhe përshkrimi i punës orienton secilin punonjës që të kryejë detyrat që i takojnë.</p>
<p>Konkluzione: Nga takimi me stafin me kohë të plotë dhe pedagogët me kohë të pjeshme u konstatua se klima e punës në IAL ishte bashkëpunuese, mbështetëse. “Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të angazhuar në pozicione pune të ndryshme. <u>Ky standard përmbushet.</u></p>	
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p>	<p>“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” është anëtare e rrjetit të universiteteve të Mesdheut EMUN, rrjet ky i përbërë universitete të njohura në botë të tilla si Universiteti Montpellier I, Francë; Universiteti Paris-Est, Francë, Universiteti Méditerranée-Aix Marseille-II, Francë; Universiteti Westminster, Londër, Angli; Universiteti Politeknik i Valencias (UPV), Spanjë etj; dhe ka krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi në formë projektesh të përbashkëta dhe shkëmbimi akademik me universitetet anëtare të këtij rrjeti. UMSH ka gjithashtu marrëdhënie bashkëpunimi me shumë IAL të rajonit të Ballkanit. Në nivel kombëtar bashkëpunon me Akademinë e Shkencave, Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë së Tiranës, Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, Shoqatën e Bankave.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ka marrëdhënie bashkëpunimi me disa organizata për realizimin e praktikave profesionale, por në këtë listë nuk përfshihen institucionet për realizimin e praktikës në kuadrin e programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit”.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p>	<p>Ky kriter nuk plotësohet.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Për këtë kriter nuk mund të shprehemi, pasi IAL nuk e ka reflektuar në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe nuk e ka dokumentuar në forma të tjera.</p>
<p>Konkluzione: Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas, por nuk ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione për të realizuar praktikat profesionale në kuadrin e programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit”. <u>Ky standard nuk përmbushet plotësisht.</u></p>	
<p align="center">VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</p>	
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel</p>	<p>“Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë” ka marrë akreditimin Institucional në janar 2012.</p>

institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;	
Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;	Sigurimi i brendshëm cilësisë kryhet nga IAL-ja. IAL përdor disa instrumenta për sigurimin e cilësisë si: kontrollon zbatimin me rigorozitet të planit mësimor sipas orare të shpallura nga Sekretaria mësimore; përdor vlerësimet formale të studentëve në fund të çdo moduli.
Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;	IAL ka përcaktuar procedura të caktuara për vlerësimin e brendshëm, por nuk ka një dokument të posaçëm të politikës së vlerësimit.
Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;	Institucioni ka mekanizma formalë për vlerësimin e programeve të studimit si për, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit; por nuk ka një paketë me dokumente mbështetës.
Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;	Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to. Nuk dokumentohet se si realizohet kjo.
Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	Institucioni është relativisht i ri. Nga raporti i vlerësimit të brendshëm dhe konsultimi me faqen e internetit të IAL rezulton se nuk ka hartuar një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Institucioni ka parashikuar që të bëjë një vlerësim pas diplomimit të brezit të parë të studentëve dhe mbi gjetjet e këtij raporti do të punojë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
Konkluzione:	
Institucioni është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit”. GVJ konstatoi se IAL-ja ka një ndjeshmëri të lartë në drejtim të sigurimit të cilësisë të programeve, por të paformalizuara plotësisht në një dokument të politikës së sigurimit të cilësisë. GVJ nuk mund të japë një gjykim të plotë në lidhje me këtë standard.	

Analiza SWOT për implementimin e programit të studimit

Pikat e Forta	Pikat e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> • Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” është një program që i përgjigjet kërkesave të tregut të punës. • Programi i studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” integron përvojën më të mirë vendase dhe të huaj. • Plan mësimor i programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” respekton standardet bashkëkohore të programeve të ciklit të dytë të studimeve. • Infrastruktura bashkëkohore dhe kushtet mjaft të mira për zhvillimin e procesit mësimor. • Tregues cilësor të personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm që garantojnë përmbushje të qëllimeve të programit të studimit. • Personel drejtues që menaxhon në mënyrë të efektshme institucionin dhe programin. • Marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore dhe të fushave të tjera në funksion të zhvillimit të institucionit dhe të realizimit të programeve të studimit. • Bashkëpunim i frytshëm pedagogë studentë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesa më e madhe e lëndëve mësimore të programit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” nuk pasqyrojnë zbatime në fushën e menaxhimit të arsimit. • Ka një numër të kufizuar të studentëve në programin “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi”. • Vërehet një raport disproporcional ndërmjet numrit të personelit të brendshëm dhe atij të jashtëm në favor të këtij të fundit. • Mungon një politikë e dokumentuar për realizimin e kërkimit shkencor². • Mungon një politikë e dokumentuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë. • Mungon një dokument i shkruar për zhvillimin e praktikës profesionale³. • Ka një numër të kufizuar të literaturës në dispozicion të programit të studimit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi”.
Mundësi	Pengesat
<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesa e tregut të punës për menaxherë të arsimit. • Kërkesa e studentëve që mbarojnë ciklin e parë për të ndjekur programe të Masterit Profesional. • Marrëveshja e bashkëpunimit me rrjetin e EMUN-it dhe universitete të tjera në rajon. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e konkurrencës si rezultat i një ofrimit të një numri të konsiderueshëm të programeve për administrimin e arsimit nga IAL të tjera. • Numri i kufizuar i personelit të brendshëm. • Numri i madh i stafit me kohë të pjesshme që vjen nga universitetet publike dhe ose institucione të tjera.

² IAL ka sjellë një dokument shtesë që ka hartuar një plan strategjik të kërkimit shkencor për 2012

³ IAL ka sjellë programin orientues për praktikën profesionale si dokument shtesë.

Rekomandime

1. Të plotësohet korniza rregullatore me rregulla për kërkimin shkencor, praktikën profesionale, për procedurën e diplomimit, për pronësinë intelektuale, për regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave të IAL-së, të studentëve dhe të personelit.
2. Të plotësohet dokumenatacioni që orienton zhvillimin e IAL-së dhe të politikave të veçanta të tij si, dokumenti i planit strategjik të zhvillimit, dokumenti i politikës së kërkimit shkencor, dokumenti i politikës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, dokumenti i praktikës profesionale, dokumenti i vlerësimit të studentëve.
3. Të bëhet studimi i tregut në mënyrë që të sigurohet një numër më i madh i studentëve për të realizuar me eficiencë programin.
4. Të rritet numri i pedagogëve me kohë të plotë.
5. Të institucionalizohet sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë që të garantojë monitorimin dhe vlerësimin periodik të cilësisë në IAL.
6. Të krijohet një sistem elektronik i të dhënave dhe të pëmirësohet regjistrimi i të dhënave të shkuara nga Sekretaria mësimore.
7. Të pasurohet faqja e internetit e IAL-së që të informojë dhe të garantojë transparencë për programin e studimit programit “Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimi” duke publikuar, planin mësimor, programet e lëndëve, rregulloren e studimeve, politikën e kërkimit, politikën e praktikës profesionale, politikën e vlerësimit, listën e personelit, temat e mikrotezave dhe listën e udhëheqësve, veprimtaritë shkencore në kuadrin e programit.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof. Dr. Nikoleta Mita (Kryetare)
2. Prof. Dr. Raimonda Duka (Anëtare)

Tiranë, 21 maj 2012